



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 471/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik Pokret za Goru (PG), me seli në fshatin Radusha, komuna e Dragashit., paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 07.11.2019, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.471/2019 i datës 08.11.2019, i paraqitur nga subjekti politik Pokret za Goru (PG), kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 07.11.2019, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 08.11.2019, ka pranuar apelin Anr.471/2019, të paraqitur nga subjekti politik Pokret za Goru (PG), me të cilën pretendon se gjatë numërimit të votave në disa vendvotime në teritorin e Komunës së Dragashit, kanë ndodhur disa malverizime me vota, ku subjekti politik në fjalë është dëmtuar, dhe si rezultat i kësaj ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet: Shkolla e Mesme „Ruzhdi Berisha“ 0501A dhe Shkolla Filllore „Fetah Sylejmani“ 0501X, duke shtuar se në këto dy vendvotime në bazë të rezultateve aktuale të paraqitura janë 24 vota nga 50 të pritura; Shkolla Filllore „Zenuni“ në fshatin Brod 0502A - Rezultate të paraqitura 18 nga 70 të pritura; Shkolla Filllore „Restelica“ 0503A - Rezultate të paraqitura 145 nga 200 të pritura; Shkolla Filllore „Svetlost“ 0504A - Rezultate të paraqitura 10 nga 30 të pritura; Shkolla Filllore „9 Maji“ 0505A - Rezultate të paraqitura 55 nga 90 të pritura.

Në përgjigje në apel të datës 09.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se në bazë të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013, procedura e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve nuk lejon asnjë Formular të Rezultateve të kaloj (procedohet si i rregullt) nëse nuk përputhen votat e subjekteve me votat e kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, atëherë Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim ose subjekti ka vota dhe kandidatët nuk kanë vota, Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim. Auditimi kontrollon të gjitha këto raste dhe në bazë të të gjeturave përgatit raportin . QNR në bazë të raportit të Auditimit rekomandon KQZ-në, që vendvotimet që kanë probleme të kësaj natyre të rinumërohen. Bazuar në arsyet e lartcekura

si dhe në nenin 5 paragrafi 7 i Rregullës së PZAP-së Nr.02/2015, KQZ-ja, pohon se apeli është i pabazuar dhe propozon të refuzohet.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresave tjera të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se paraqitësi në apel me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e tij, prandaj Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me prova konkrete, pasi që paraqitësi i apelit vetëm dyshon se ka shkelje dhe pritjet e tij për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkuptojnë se ka mospërputhje të rezultatit. Andaj, si i tillë apeli është jo i argumentuar dhe për rrjedhojë i pa bazua pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 të LZP-së.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 dhe nenit 118 par. 1 të LZP-së, Paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.471/2019 më datë 10.11.2019

Kryesues i Panelit
Rrustem Thaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.